



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 30 dhjetor 2025
Kodi i ZRRE-së: V_3013_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 25, Nenin 26 par. 1 nënpar. 1.2, Nenin 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e Nenit 18 dhe Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos SH.A. për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Tarifave të Energjisë Termike, të dorëzuar me datë 3 korrik 2025, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Termike me dokumentacionin relevant sqarues,

në seancën e mbajtur me datë 30 dhjetor 2025, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (në tekstin e mëtejshëm: MAR)** në vlerën **11,463,803 €** për ndërmarrjen NQ Termokos SH.A., që do të mbledhen nga tarifat e energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorët fundorë për sezonin 2025/2026.
- II.** Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Termokos SH.A.
- III.** Ky vendim do të zbatohet nga ndërmarrja NQ Termokos SH.A., duke filluar nga data e aprovimit deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

A R S Y E T I M

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 3 korrik 2025 nga NQ Termokos SH. A., ka pranuar aplikacionin/kërkesën për shqyrtimin dhe aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që ndërmarrjes i lejohet të mbledhë nga tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë.
- ZRRE me rastin e përcaktimit të të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR), ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:
 - Të dhënat dhe informatat e dorëzuara bashkangjitur me kërkesën për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara, të datës 3 korrik 2025;
 - Komentet me shkrim lëshuar nga ZRRE me 30 korrik 2025, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të të dhënave dhe informatave të dorëzuara bashkangjitur;



- Të dhënat dhe informatat e korrigjuara dhe të plotësuara sipas komenteve me shkrim të ZRRE-së, ri-dorëzuar nga NQ Termokos SH.A. me datë 11 gusht 2025;
 - Raportin për Konsultim Publik: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos SH.A.– sezoni i ngrohjes 2025/2026;
 - Komentet e pranuar për raportin në fjalë gjatë periudhës së konsultimit publik (15 – 29 dhjetor 2025);
 - Përgjigjet e ZRRE-së në komentet e pranuar;
 - Raportin Final për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos SH.A. – sezoni i ngrohjes 2025/2026.
- Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Bashkangjitur: Raporti Rregullativ: Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara për NP Termokos sh.a. – sezoni i ngrohjes 2025/2026

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së